ORGANIZIMI I MASTERIT

Master zgjat dy vjet. Strukturohet në 3000 orë mësimore (120 kredite ECTS), që i kushtohen leksioneve në auditor, praktikës (fieldwork) dhe studimit individual (paper, dossier pune, tutoring, tema përfundimtare).

Masteri ndahet në tri cikle:

- nga janari në korrik 2010 pranë Universitetit "Zoja e Këshillit të Mirë"
- nga tetori 2010 në prill 2011 pranë Universitetit "Zoja e Këshillit të Mirë"
- nga qershori në dhjetor 2011 pranë një institucioni/organizate publike ose private.

Masteri do të zhvillohet në italisht dhe në shqip. Data e fillimit të leksioneve të Masterit është 25 janari 2010.

KUSH MUND TË REGJISTROHET

- kandidatët që zotërojnë një diplomë të sistemit 3+2 (ose 4 vjeçare të sistemit të vjetër) ose të njëvlershme të lëshuar nga një universitet i Bashkimit Evropian, një universitet publik shqiptar apo një universitet privat shqiptar apo i huaj i akredituar në çastin e lëshimit të diplomës universitare.

TAKSA E REGJISTRIMIT DHE BURSAT E STUDIMIT

6.000 euro. Ente publike dhe private do të vënë në dispozicion bursa studimi për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të regjistrimit.

PARAQITJA E KËRKESAVE

Kërkesat për pjesëmarrjen në konkurs duhet të dorëzohen në Sekretarinë e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Politike nga 12 deri në 20 tetor 2009.

ZYRA E ORIENTIMIT TË MASTERIT

- do të jetë e hapur pranë Universitetit "Zoja e Këshillit të Mirë" nga data 5 deri më 20 tetor 2009.

ORARI

e hënë – e mërkurë – e premte	16.00 – 18.00
e martë – e enjte	10.00 – 12.00

Info

04 – 2273289 (UZKM) e.karma@unizkm.edu.al
04 – 2247431 (MAGIS) magis@albmail.com

www.unizkm.al

grafiplus design

MASTER UNIVERSITAR NDËRKOMBËTAR I PËRBASHKËT I NIVELIT II

Governance dhe zhvillim territorial

Masteri lind nga bashkëpunimi mes Universitetit "Zoja e Këshillit të Mirë" të Tiranës, Universitetit të Palermos, Institutit të Formimit Politik "Pedro Arrupe" Qendra e Studimeve Shoqërore të Palermos dhe Magis Shqipëri.

Masteri formon figurën e Ekspertit të politikave publike: një figurë profesionale që është në gjendje të përgatisë vendime politike, të aktivizojë itinerare projektesh, të vlerësojë zbatimin dhe ndikimin e politikave publike në terren.

Core Curriculum	
Policy process Sektori etik Sektori metodologjik Sektori juridik Sektori politologjik Sektori ekonomik	Politikat sektoriale Politika ndërkombëtare dhe e bashkëpunimit Politika sociale Politika e sigurisë vendore Politikat kulturore Politika të zhvillimit dhe ekonomike
Specializimi Fieldwork dhe tema përfundimtare	

MUNDËSI PUNËSIMI

Eksperti që formojmë gjen vend si drejtues - manager apo si anëtar stafi në sektorin publik dhe privat, kombëtar dhe ndërkombëtar.
Vepron si profesionist i lirë, më vete apo si konsulent i jashtëm, në marrëveshje me drejtuesin politik dhe/ose drejtorinë administrative të subjekteve publike apo private; ose gjen vend pranë:
- administratës publike, enteve private, zyrave të vlerësimit dhe shërbimeve të kontrollit të brendshëm;
- shoqërive të konsulencës, shoqatave dhe organizatave të sektorit të tretë;
- enteve kërkimore që merren në shkallë të ndryshme me politikat publike.

STRUKTURA E MASTERIT

Masteri ndahet në tri cikle:
- në të parin zhvillohet kursi në "policy process";
- në të dytin trajtohen temat e politikave sektoriale: "të mendosh në mënyrë globale, të veprosh në mënyrë vendore: kontekstualizimin dhe aktualizimi i politikave publike";
- në të tretin parashikohet praktika (fieldwork) pranë një institucioni/organizate publike apo private në njërin prej sektorëve të specializimit të zgjedhur më parë ("siguri", "emigracion", "zhvillim vendor", "welfare").
Diskutimi publik i temës përfundimtare përmbyll periudhën e formimit. Në përfundim të ecjes formuese, Universiteti "Zoja e Këshillit të Mirë" lëshon diplomën e Masterit të përbashkët të nivelit II në "Governance dhe zhvillim territorial" me firmën e Rektorit të këtij Universiteti dhe të Rektorit të Universitetit të Palermos.

ORIENTIMI PROFESIONAL

Shoqërimi personal i ecjes intelektuale është boshti integrues i përvojave të ndryshme formuese të këtij programi. Stafi i Masterit i ka vënë vetes një objektiv formues me cilësi të lartë. Por jo vetëm. Integrimi i programit me ente publike dhe private të angazhuara në fushën shoqërore është një përparësi e Masterit. Docentët dhe personeli administrativ i kushtojnë vëmendje të madhe përzgjedhjes së organizatave dhe enteve, publike, private, non-profit, kombëtare dhe ndërkombëtare, me të cilat vendosin marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi për realizimin e praktikës. Ky çast formues është thelbësor. Pjesëmarrësit përftojnë aftësitë e profilit profesional të propozuar, një kompetencë origjinale në sektorët e politikave të vendosura si parësore. Fieldwork përbën një "formim në terren" dhe zhvillohet në një kontekst punësimi të vërtetë me qëllim përftimin e një njohjeje të drejtpërdrejtë të botës së punës. Studentët e Masterit kanë përkrah një nga docentët që siguron nivelin akademik të planit formues të zhvilluar dhe nga një tutor i Entit pritës që ka si funksion organizimin e veprimtarive të zhvilluara.